



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

A K T N O R M A T I V

Nr. _____, datë _____

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV
NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE
GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT
TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhet shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Pas fjalisë së parë, të pikës 16, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rindërtimin, çdo strukturë/objekt tjetër që konsiderohet i domosdoshëm, vendoset në dispozicion për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19.”.

2. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjes vetëm në fasha orare të caktuara dhe të pashoqëruar me persona të tjerë në krah, dënohen me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe me mospërfitimin nga paketa financiare e solidaritetit dhe bllokim 3 (tre) muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.”.

Neni 2

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Masa me karakter detyrues

1. Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte ushqimore dhe produkte të tjera, me shumicë, të domosdoshme për përballimin e situatës së epidemisë, janë të detyruar të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19. Mallrat e blerë, me qëllim përballimin e situatës, në rast kur me përfundimin e situatës së epidemisë nuk janë shitur në tregun e lirë, me kërkesë të subjektit, mund t’i shiten Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas faturës me të cilën këto mallra janë blerë. Rregullat dhe procedurat për blerjen e këtyre mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë barna/pajisje mjekësore, subjekte që prodhojnë barna dhe pajisje mjekësore dhe subjektet që ofrojnë shërbime shëndetësore, të jenë në gadishmëri dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar furnizime me barna dhe pajisje mjekësore dhe për të ofruar shërbime shëndetësore të nevojshme, në kuadër të përballimit të situatës së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19.
3. Mosmarrja e masave, sipas përcaktimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dënohet me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë dhe me përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.”.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA